



Funded by  
the European Union

# Viktimat e padrejtësisë

Performanca e institucioneve  
të Kosovës në mbrojtjen  
e punëtorëve

IDRIZ  
GERBESHI  
17 03 1967  
02 06 2020

NAIM MUSTAF  
EMINI

01.06.1981 - 01.06.2019

VALON A.  
BERISHA

04.07.1988

24.05.2018

E PËRKUJTON  
FAMILJA

**Autor:** Jetlira Buzhala

**Hulumtues:** Behar Mustafa, Kastriot Berisha, Adelina Ahmeti, Jetlira Buzhala

**Redaktor:** Kreshnik Gashi

**Lektura:** Perparim Isufi

# Përmbajtja

Hyrje	4
Përmbledhja Ekzekutive	6
Metodologjia	8
1. Sfidat ligjore të rregullimit të marrëdhënieve të punës	9
2. Kapacitetet e limituara të Inspektoratit të Punës	10
3. Vendimmarrja dhe ankesat në Inspektoratin e Punës	12
3.1 Analizimi i rasteve të trajtuara nga Inspektorati I Punës	12
4. Performanca e gjyqësorit në trajtimin e rasteve civile	12
4.1 Ngecjet në trajtimin e çështjeve civile	17
4.2 Ngecjet në trajtimin e rasteve penale	19
4.3 Performanca e prokurorisë në trajtimin e rasteve	20
4.3.1 Trajtimi i rasteve në rajonin e Gjakovës	22
4.3.2 Trajtimi i rasteve në rajonin e Ferizajit	23
4.3.3 Trajtimi i rasteve në rajonin e Prizrenit	24
4.3.4 Trajtimi i rasteve në rajonin e Gjilanit	25
4.3.5 Trajtimi i rasteve në rajonin e Prishtinës	27
4.3.6 Trajtimi i rasteve në rajonin e Pejës	28
4.3.7 Trajtimi i rasteve në rajonin e Mitrovicës	29
4.4 Gjetjet e përgjithshme në trajtimin gjyqësor	30
5. Ngecjet në vlerësimin e rrezikut dhe kontrollet shëndetësore	31
6. Gjobat e Administratës Tatimore të Kosovës ndaj bizneseve që shkelin ligjin	33
7. Rekomandime	34



## Hyrje

Qendra për Trajnime dhe Burime për Avokim - ATRC dhe Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese - BIRN Kosova nga fillimi i vitit 2022 ka nisur realizimin e projektit “Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të punëtorëve dhe grupeve të marginalizuara në tregun e punës” përkrahur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Qëllimi i ndërhyrjes ishte të ndikojë në përmirësimin e kushteve të punës për kategoritë e pambrojtura të punonjësve, veçanërisht në sektorin privat, duke përfshirë shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës për gratë dhe burrat, përmes promovimit të dialogut social midis punëtorëve dhe bartësve të detyrës.

Synimet e tjera të projektit janë: 1) rritja e kapaciteteve të OJQ-ve, sindikatave, dhe akterëve të tjerë në trajtimin e të drejtave të punës, 2) ofrimi i analizave specifike për problematikën dhe 3) rritja e raportimit qytetar për shkeljet e rregullave nga marrëdhënia e punës.<sup>1</sup>

Në kuadër të këtij projekti, BIRN ka realizuar fushata vetëdijesuese dhe një kampanjë raportimi për të inkurajuar raportimin qytetar për shkeljet e rregullave në marrëdhënien e punës. Kjo është bërë fillimisht me krijimin e një platforme në KALLXO.com, ku qytetarët mund të raportojnë mbi shkeljet e të drejtave të punëtorëve, e cila quhet “Shkeljet e të drejtave të punës”.

Gjatë këtyre dy viteve, BIRN ka pranuar mbi 300 raportime nga punëtorë dhe sinjalizues që denoncuan shkelje të të drejtave të punëtorëve. Si rezultat i kampanjës dhe një metodologjie të kombinuar, rastet e hulumtuara nga BIRN janë dërguar në Inspektoratin e Punës. Mbi 40 operacione kontrolli në bashkëpunim me Inspektoratin e Punës janë realizuar gjatë dy viteve dhe aty janë shqiptuar dhjetëra gjoba dhe janë konstatuar parregullsi serioze në implementimin e Ligjit të punës dhe Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë. BIRN realizoi fushatë vetëdijesuese përmes mesazheve edukative, TV reportazheve e debateve, infografikave, trajnimeve për gazetarë e hulumtime të cilat arritën mbi 1 milion shikime e lexime në rrjetet sociale.

Rritja e raportimit qytetar për parregullsitë është evidentuar në raportet e pranura ndërsa bizneset e inspektuara kanë reflektuar në përmirësimin e dukshëm të kushteve të punës, veçanërisht të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Të dhënat tregojnë se shtimi i aktiviteteve të OJQ-ve dhe sindikatave në vitet e fundit ka rritur presionin publik për reformë në fushën e marrëdhënies së punës.

Qeveria ka njoftuar për rritje të numrit të punëtorëve të regjistruar në Kosovë, ndërsa diskutimi dhe kritika në publik është e evidente për mungesën e performancës së Inspektoratit të Punës dhe sistemit të drejtësisë.

Të dhënat nga Inspektorati tregojnë se ndër vite trendet e inspektimeve janë rritur. Në vitin 2020 ishin 3 mijë e 832 inspektime, në vitin 2021 ishin 3 mijë e 22 inspektime, në vitin 2022 ishin 6 mijë e 316 inspektime ndërsa nga janari deri në tetor 2023 janë realizuar 6 mijë e 347 inspektime.

---

<sup>1</sup> <https://kallxo.com/shkeljet-e-te-drejtave-te-punes/>

Rritja e numrit të inspektorëve ka rritur edhe numrin e gjobave. Të dhënat tregojnë se në vitin 2020 ishin shqiptuar vetëm 115 gjoba, në vitin 2021 ishin shqiptuar 281 gjoba, në vitin 2022 ishin shqiptuar 359 gjoba, kurse në 10 muajt e vitit 2023 inspektorati shqiptoi 820 gjoba.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën<sup>2</sup> për vitin 2023 konstaton se vendi përballet me probleme në garantimin e një ambienti të përshtatshëm për punëtorët. Raporti konstaton se gratë dhe grupet e marginalizuara të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, janë të diskriminuara në tregun e punës. Në aspektin legjislativ, raporti i Komisionit Evropian nënvizon nevojën për harmonizimin e Ligjit të punës me direktivën e BE-së për balancimin e punës dhe jetës. Ky ligj ende nuk është miratuar.

Edhe Ligji për pagën minimale, i miratuar në Kuvend më 13 korrik 2023, vazhdon të presë aktvendimin nga Gjykata Kushtetuese, pasi që në korrik të këtij viti është dërguar për shqyrtim të kushtetutshmërisë nga partia opozitare AAK<sup>3</sup>. Sipas këtij Ligji, paga minimale do të jetë 264 euro, dhe për krahasim me vitin 2022, duke qenë se Kosova ka pasur pagë dyshkallëshe minimale, pagat janë rregulluar me nivele të moshës. Për personat deri në moshën 35-vjeçare paga ka qenë 135 euro në muaj, ndërsa për ata mbi 35-vjeçare 170 euro në muaj.

Si pasojë e mbetjes pezull të Ligjit për pagën minimale, punëtorët vazhdojnë të vuajnë nga mungesa e një ambienti të sigurtë e të përshtatshëm të vendit të punës ku garantohet respektimi i ligjit.

---

<sup>2</sup> [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/S&D\\_2023\\_692%20Kosovo%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/S&D_2023_692%20Kosovo%20report.pdf)

<sup>3</sup> <https://kallxo.com/lajm/presidentja-nuk-do-ta-dekretoj-ligjin-per-pagen-minimale-deri-ne-vendimin-e-kushtetueses/>.  
Presidentja nuk do ta dekretojë Ligjin për pagën minimale deri në vendimin e Kushtetueses, Kallxo.com, Oasur më 8 nëntor 2023

## Përmbledhje ekzekutive

Të dhënat nga monitorimi i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese - BIRN Kosova dokumentojnë se ekzekutivi dhe gjyqësori kanë bërë një zhvillim të vogël në adresimin e çështjeve lidhur me marrëdhënien e punës.

Hulumtimi shpërfaq se numri i punëtorëve të vdekur dhe punëtorëve të lënduar në vendin e punës vazhdon të jetë i lartë. Për më tepër, gjetjet gjatë inspektimeve të bizneseve rezultojnë të jenë serioze.

Gjatë viteve 2021 - 2023, 33 punëtorë kanë vdekur nga 763 aksidente në punë. Statistikat tregojnë që vetëm në gjashtë muajt e parë të vitit 2023 kanë vdekur 9 punëtorë. Kjo tregon një rritje të rasteve të vdekjeve të punëtorëve si pasojë e aksidenteve në vendin e punës.

Në një situatë ku reformat ligjore janë të ngadalta dhe kapacitetet e institucioneve për të kontrolluar e respektuar këto reforma janë të limituara, Kosova nuk po arrin të ndalojë vdekjet dhe aksidentet në vendin e punës e as të garantojë ndjekje penale për shkelësit e ligjit.

Qeveria e Kosovës me hapa të ngadalta është duke i adresuar nevojat për një reformë ligjore si dhe rritjen e resurseve të trupave inspektues. Në anën tjetër, Ligji i punës ende nuk është harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian ndërsa Ligji për pagën minimale është i bllokuar në Gjykatën Kushtetuese.

Të dhënat nga hulumtimi i BIRN tregojnë se:

- Nga viti 2016 deri në qershor të vitit 2023 kanë ndodhur 1,072 aksidente, prej tyre 102 me fatalitet, gjë që ka bërë që trendi i vdekjeve të vazhdojë të jetë i lartë
- Reforma ligjore ende nuk është implementuar dhe vendi vazhdon të vuajë pasojat e reformës së ngadalte
- Zbatimi i Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë është në nivel të ulët dhe shpeshherë edhe i papërfillshëm nga punëdhënësit
- Një numër shumë i vogël i bizneseve kanë përmbushur obligimet që dalin nga Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë këtu vlerësimin e rrezikshmërisë në punë dhe obligimet për pajisjen e stafit me certifikata shëndetësore
- Vendi vazhdon të ketë shifra të larta të punëtorëve të cilët janë pa kontrata pune si dhe të mospërmushjes së obligimeve të tjera nga ana e punëdhënësve
- Inspektorati i Punës ende nuk ka arritur t'i ketë kapacitetet e plota operationale për të përmbushur obligimin ligjor
- Performanca e Inspektoratit të Punës vazhdon të ketë sfida sidomos në numrin e inspektimeve
- Inspektorati i Punës nuk ka regjistër të bizneseve "recidiviste" të cilat janë gjobitur nga ky institucion
- Në metodologjinë e punës, Inspektorati i Punës nuk ka ndonjë planifikim strategjik të bazuar në rrezik lidhur me inspektimet që bëhen
- Inspektorati i Punës nuk ka dorëzuar kallëzime penale gjatë inspektimeve të bizneseve që kanë bërë shkelje ligjore

- Gjobitja e bizneseve nga Inspektorati i Punës kryhet pa procedurë e cila do të përcaktonte llogaritjen e rrethanave lehtësuese apo rënduese të rastit përkatës
- Institucionet që trajtojnë çështjet e punëtorëve vazhdojnë të kenë mungesë komunikimi dhe nuk shkëmbejnë informacione njëra me tjetrën
- Kontrollat mjekësore për punëtorët në nivel vendi janë në numër të vogël
- Institucionet e drejtësisë vazhdojnë të kenë nivel të ulët të performancës në trajtimin e kontesteve të punës
- Veprimet e institucioneve të drejtësisë karakterizohen me vonesa të shumta në adresimin e çështjeve të punës në aspektin penal
- Gjykatat e vendit shkelin seriozisht parimin që çështjet e punës të gjykohen me prioritet
- Vetëm 20% e rasteve civile kanë arritur të marrin epilog përfundimtar në gjykata
- Institucionet e drejtësisë, duke mos i adresuar penalisht çështjet e punës, vazhdojnë të garantojnë amnisti për bizneset të cilat nuk i respektojnë rregullat e punës dhe rregullat e sigurisë në punë
- Prokuroria e Shtetit nuk arrin të përfundojë të gjitha çështjet penale ndërsa në prokuroritë siç është ajo e Mitrovicës nuk ka asnjë aktakuzë të ngritur për çështje të punës
- Hetimet penale në aksidentet e punës janë të cekta, të vonuara dhe nuk sigurojnë prova të detajuara për të argumentuar çështjet
- Gjykatat kanë dhënë dënime të papërfillshme për biznesmenët në rastet kur u shkaktuan aksidente, këto dënime janë pa pasoja juridike për bizneset pasi janë me gjobë si dhe me kusht
- Gjykata rezulton të jetë shumë e butë me punëdhënësit të cilët kanë rrezikuar jetën dhe shëndetin e punëtorëve në vendin e punës
- Numri i aktakuzave të ngritura ndaj shkelësve të dispozitave për siguri në punë ka shënuar trend të uljes gjatë viteve 2021, 2022 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2023
- Performanca e gjykatave në zgjidhjen e rasteve penale është e ulët pasi më pak se 50% e rasteve penale janë zgjidhur nga gjykata

## Metodologjia

Ky raport paraqet të dhëna nga monitorimi direkt i rasteve të aksidenteve në punë dhe analizimi i dosjeve të arkivuara në Inspektoratin e Punës dhe në gjykatat e vendit.

Për realizimin e këtij raporti BIRN ka grumbulluar të dhëna edhe përmes intervistave të thella dhe analizimit të të dhënave statistikore.

Të dhënat kryesore të raportit janë nxjerrë nga analizimi i rasteve tashmë të përfunduara të cilat ofrojnë një pasqyrë të qartë për rrjedhën e rasteve të aksidenteve në punë.

BIRN ka analizuar dosjet e arkivuara në gjykata për të nxjerrë nga aty të dhënat dhe mësimet se ku kanë gabuar institucionet, që nga nisja e rastit në Polici e Inspektorat, deri te përfundimi i procesit në gjykatë.

Rastet e zgjedhura për hulumtim të gjykatave në Kosovë janë zgjedhur në mënyrë rastësore, nga konteksti kohor 2021, 2022 dhe 6-mujorëshi i parë i vitit 2023. Ndërsa rastet nga Inspektorati i Punës të zgjedhura në mënyrë rastësore poashtu, përfshijnë periudhën 1 janar 2022 - 30 qershor 2023. Nga këto raste janë analizuar 6 vendime të shkallës së dytë, të cilat kanë vërtetuar gjobat e shqiptuara nga shkalla e parë.

Numri i dosjeve të hulumtuara që janë trajtuar në gjykatë është si vijon:



Përpos analizimit të dosjeve, ky raport paraqet të dhëna krahasimore nga raportet statistikore të Inspektoratit të Punës, Prokurorisë së Shtetit dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Krahasimet e statistikave i janë nënshtruar një procesi të analizimit kualitativ nga ku janë nxjerrë përfundime për trendet.

Përpos të dhënave statistikore, BIRN ka grumbulluar të dhëna duke përdorur intervistat dhe kërkesat për qasje në dokumente publike.

Raporti paraqet edhe të dhëna nga anketat me kompani të certifikuara për të realizuar kontrole të sigurisë në punë e po ashtu të dhëna statistikore nga institucionet shëndetësore



# 1. Sfidat ligjore të rregullimit të marrëdhënieve të punës

Baza për rregullimin e marrëdhënieve të punës në Kosovë është Ligji i punës. Me gjithë kritikën dhe kërkesat e vazhdueshme për ndryshime në këtë Ligj, që nga viti 2010 institucionet e Kosovës nuk kanë arritur të ndryshojnë këtë Ligj dhe të adresojnë problemet që i krijon në terren.

Mbrojtja e punëtorëve në aspektin ligjor në vendin e punës fillon që nga Kushtetuta, e cila përmban norma me të cilat ndalon punën e detyruar dhe garanton zgjedhjen e lirë të profesionit e vendin e punës.<sup>4</sup>

Infrastruktura ligjore synon që sigurinë dhe shëndetin ta trajtojme në Ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë<sup>5</sup>, i cili detyron punëdhënësit të zbatojnë masa konkrete të sigurisë që punëtorët të punojnë duke mos rrezikuar shëndetin ose jetën e tyre. Por të dhënat tregojnë që ky Ligj nuk zbatohet në terren, sidomos në sektorët e rrezikshëm të ndërtimitarisë. Sfidat në aspektin ligjor pa dyshim janë ato të Ligjit të punës.

I miratuar në dhjetor të vitit 2010, ky Ligj nuk është i harmonizuar plotësisht me standardet e Bashkimit Evropian. Qeveria është në proces të reformimit të standardeve të këtij Ligji, i cili është në rishikim. Sipas koncept-dokumentit për rregullimin e marrëdhënieve të punës, Ligji i ri duhet të adresojë organizimin e kohëzgjatjes së punës, mbështetjen e rinisë në punësim, pagën e barabartë për gra dhe burra, ndalimin e diskriminimit gjatë procesit të rekrutimit, mbrojtjen e grave gjatë shtatzënisë dhe gjidhënies, pushimin prindëror, etj.

BIRN ka gjetur se çështjet të cilat janë aktuale në tregun e punës por nuk janë fare të parapara me Ligjin e tanishëm të punës janë: “puna në shtëpi, mobingu<sup>6</sup>, agjencitë e përkohshme të punësimit, mbrojtja e punëtorëve në rastet e falimentimit të punëdhënësve, informimi dhe konsultimi i punëtorëve, këshillat e punëtorëve, ndalimi i konkurrencës, etj.”<sup>7</sup>

Rregullimi aktual ligjor nuk parasheh mbulimin e kompensimit të pushimit mjekësor pas mbarimit të 20 ditëve pune, as nga punëdhënësi e as nga Fondi për Sigurime Shëndetësore.<sup>8</sup> BIRN gjeti se ligjet e tjera, përfshirë atë të Prokurimit publik, nuk parashohin sanksione apo kërkesa specifike që bizneset përfituese të parasë publike të respektojnë në mënyrë rigoroz rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë. Si rrjedhojë, edhe punëtorët që paguhen nga paratë publike vazhdojnë të jenë të rrezikuar përfshirë këtu nga vendpunishtet e ndërtimeve publike të cilat janë të pasigurta për ta.

Në aspektin penal në kuadër të Kodit Penal, një kapitull i veçantë u kushtohet veprave penale të kryera gjatë marrëdhënieve të punës. Mospagesa e pagës, e drejta e pushimit, e të drejta të tjera që i takojnë punëtorit në vendin e punës janë të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në 1 vit nëse nuk respektohen. Kurse, nëse dikujt i mohohet apo kufizohet e drejta në punësim apo kushtet e njëjta, dënimi është deri në 2 vite burgim ose me gjobë.

Kodi parasheh edhe dënime të larta kur punëtorëve u rrezikohet jeta dhe shëndeti në vendin e punës nga lëndime të rënda trupore. Maksimumi i dënimit për punëdhënësit është 10 vite burgim, përveç nëse lëndimi kryhet nga pakujdesia, atëherë dënohen deri në 5 vite burgim. Kurse, kur rasti ka pasojë vdekjen e personit, dënueshmëria maksimale është 12 vite.

BIRN gjeti se nuk ka obligime ligjore që institucionet e vendit të njoftojnë njëra-tjetrën për shkeljet penale të zbuluara në vendet e punës.

Në sistemin e drejtësisë BIRN gjeti se lëndët e punës llogaritet të jenë prioritare mirëpo të dhënat tregojnë se gjykatat kanë neglizhuar këtë prioritet duke i lënë qytetarët të presin me vite për një zgjidhje.

<sup>4</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 28 dhe 49.

<sup>5</sup> Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë, LIGJI NR. 04/L-161, i miratuar në qershor 2013

<sup>6</sup> Mobingu - përqeshje dhe nënçmim i vazhdueshëm në vendin e punës, dhënie e obligimeve poshtëruese dhe/apo bërtitje e vazhdueshme dhe fyerje me çka në mënyrë të drejtpërdrejtë sulmohet dinjteti i punëtorit

<sup>7</sup> Drafti Fillestar i Koncept-Dokumentit për Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës, 2018

<sup>8</sup> Drafti Fillestar i Koncept-Dokumentit për Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës, 2018

Divizionet civile të departamenteve të përgjithshme të gjykatave themelore të vendit nuk kanë gjyqtarë të caktuar që trajtojnë ekskluzivisht kontestet e punës.<sup>9</sup>

Sipas koncept-dokumentit të Ministrisë së Drejtësisë, i aprovuar nga Qeveria në gusht të këtij viti, parashihet themelimi i Gjykatës së veçantë të Punës si një ndër nën-opcionet për kontestet e punës.

Kjo Gjykatë do të themelohej me ligj të ri, me seli qendrore në Prishtinë, e do të funksiononte në dy shkallë dhe do t'i trajtonte të gjitha kontestet e punës, pavarësisht statusit të punëdhënësit, qoftë në sektorin publik apo privat.

Përmes kësaj, Gjykata e Punës do të kishte departament të veçantë për kontestet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Shkallshmëria e kësaj Gjykate do të përfshinte kompetencat e divizioneve civile të gjykatave themelore dhe asaj të Apelit.

Nismat ligjore janë në fazat fillestare dhe implementimi i tyre kërkon ndryshime në terren, përfshirë këtu rregullore dhe procedura të veçanta.

## 2. Kapacitetet e limituara të Inspektoratit të Punës

Inspektorati i Punës është institucioni i vetëm i thirrur të kontrollojë zbatimin e legjislacionit nga fusha e marrëdhënies së punës si dhe sigurisë dhe shëndetit në punë.<sup>10</sup>

Kosova ka mbi 400,000 të punësuar në mbi 85,000 biznese aktive. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit në tërë këtë hapësirë u është besuar vetëm 82 punëtorëve të Inspektoratit të Punës.

Roli i Inspektoratit të Punës është vetëm “mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë.”<sup>11</sup>

Të dhënat statistikore tregojnë që në vitin 2023 trendet e inspektimit janë rritur në krahasim me vitin 2022.

Periudha kohore	Totali inspektimeve
2021	3,022
2022	6.316
janar - tetor 2023	6.347

<sup>9</sup> Koncept-Dokumenti për Gjykatën Administrative dhe të Punës, fq. 23, Ministria e Drejtësisë, gusht 2023

<sup>10</sup> [https://ip.rks-gov.net/?page\\_id=2556](https://ip.rks-gov.net/?page_id=2556)

<sup>11</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KO27/21, fq. 19.

Analizimi i këtyre të dhënave tregon që Inspektorati i Punës arrin t'i vizitojë afërsisht 10% të bizneseve të cilat kryejnë aktivitete në Kosovë.

Në vitin 2022, BIRN zbuloi se Inspektorati i Punës nuk i kishte dërguar në prokurori dhe në Polici rastet ku inspektorët hasnin vepra penale gjatë inspektimit.<sup>12</sup> BIRN konstatoi se praktika e Inspektoratit të Punës nuk ka ndryshuar as gjatë vitit 2023, pasi ka vazhduar vetëm me gjoba ndaj bizneseve që nuk e respektojnë Ligjin edhe pse në disa raste shkeljet mund të jenë edhe shkelje penale. Përveç kësaj, të dhënat nga intervistat me zyrtarët e Inspektoratit tregojnë që inspektimet janë kryer në kontrolle të lira pa realizuar një plan strategjik të bazuar në rrezik.

Planifikimi i inspektimeve në bazë të rrezikut është një mekanizëm të cilin e përdorin institucionet si Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, e në të cilat kontrollimi i bizneseve kryhet duke marrë informacione paraprake dhe duke bërë analiza mbi të dhënat për biznesin.

Hulumtimi i BIRN tregon se inspektorët aktualisht po përballen me mungesë të automjeteve dhe hapësirës së përshtatshme për punë.<sup>13</sup>

Rekrutimi i stafit dhe reforma e brendshme në inspektorat janë prioritetë edhe në strategjinë e Inspektoratit të Punës. Aty përmenden synimet si: reformimi i strukturës së Inspektoratit të Punës, krijimi i një sistemi informativ, planifikimi i bazuar në faktet e inspektimeve të punës, ngritja e kapaciteteve të inspektorëve, rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimit të komunikimit brenda Inspektoratit të Punës, përfshirë këtu edhe përmirësimin e infrastrukturës fizike të këtij organi.

Por, të dhënat e BIRN tregojnë që një pjesë e këtyre reformave ende nuk kanë filluar të zbatohen për shkak të mungesës së përkrahjes.

Sfida e parë me të cilën Inspektorati është përballur është rekrutimi i stafit. Të dhënat tregojnë që Inspektorati vazhdon të punojë me kapacitetet të cilat i ka në dispozicion.

Nga vitit 2022 Inspektorati ka rekrutuar 38 inspektorë të rinjë duke e ngritur numrin në 60 inspektorë.

Të dhënat nga Inspektorati i Punës tregojnë që punësimi në Inspektorat nuk është i barabartë në aspektin gjinor, pasi që në këtë institucion ka më shumë të punësuar burra sesa gra.

Edhe shtrirja gjeografike e inspektorëve është problematike. Në hartën e shtrirjes shihet se komunat e mëdha si Prizreni p.sh., kanë numër më të vogël të inspektorëve për dallim nga komunat më të vogla si Gjlani e Mitrovica.

Të dhënat tregojnë se në vitin 2023 numri i inspektorëve është rritur në 60 inspektorë, nga 37 sa kanë qenë në vitin 2022. Rritja e numrit të inspektorëve duhet të reflektojë edhe në numrin e inspektimeve, e rrjedhimisht edhe në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në terren.

Përpos numrit të inspektorëve, kapacitetet kadrovike të Inspektoratit sfidohen edhe nga mungesa e ekspertizës në fusha të caktuara. Në dokumentet strategjike, Inspektorati thekson se i mungojnë ekspertë teknikë të aftësuar për të bërë hetime aksidentesh dhe inspektime të detajuara në raste të veçanta.<sup>14</sup>

---

<sup>12</sup> [https://birn.eu.com/ep-content/uploads/2023/01/Raporti\\_ALB-BIRN-Kosovo-1.pdf](https://birn.eu.com/ep-content/uploads/2023/01/Raporti_ALB-BIRN-Kosovo-1.pdf)

<sup>13</sup> Diskutim me zv.Kryeinspektorin për marrëdhënie pune, z. Murat Vokshi, 05.10.2023

<sup>14</sup> Strategjia zhvillimore e Inspektoratit 2023-2027, faq. 9

### 3. Vendimmarrja dhe ankesat në Inspektoratin e Punës

Në vitin 2022 BIRN publikoi raportin i cili trajton mënyrën e vendimmarrjes dhe ndëshkimeve të Inspektoratit të Punës në rastet e shkeljeve të të drejtave të punëtorëve. Në këtë raport, BIRN konstatoi se një numër i lartë i rasteve të vendosura në shkallën e parë ishin hedhur poshtë apo refuzuar nga shkalla e dytë e Inspektoratit të Punës.

Gjetjet e raportit tregojnë se në vitin 2021 në shkallë të dytë janë paraqitur 1,633 ankesa të palëve kundër vendimeve të shkallës së parë, prej tyre 83 ankesa janë refuzuar si të pabaza, 798 ankesa janë aprovuar dhe 161 lëndë janë kthyer në rishqyrtim të shkallës së parë.

Të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2023 Inspektorati i Punës pati rritje të profesionalizmit në shkallën e parë. Kjo konstatohet me numrin e vogël të lëndëve të cilat janë refuzuar dhe numrin e ulët të rasteve të kthyera në rivendosje.

Sipas të dhënave nga Inspektorati i Punës, numri i ankesave që janë pranuar në shkallën e dytë për periudhën janar-qershor 2023 është 217 ankesa. Prej tyre, 203 janë refuzuar dhe 14 janë kthyer në rishqyrtim në shkallë të parë.<sup>15</sup>

Në raportin e vitit 2022 BIRN kishte konstatuar edhe vonesa në trajtimin e lëndëve. Një pjesë e madhe e rasteve nuk ishin vendosur në afatin prej 30 ditësh ashtu siç e parasheh Ligji për procedurën administrative. Në analizimin e rasteve të 2023, BIRN vëren se respektimi i afateve nga Inspektorati i Punës vazhdon të ketë probleme.

#### 3.1 Ngecjet në trajtimin e çështjeve civile

Kontestet e punës trajtohen në fazën e fundit në gjykatë. Sipas ligjit, zgjidhja e kontesteve të punës është prioritet për gjykatat, mirëpo të dhënat e siguruara nga BIRN tregojnë që gjykatat kanë injoruar plotësisht këtë parim.

BIRN ka marrë të dhënat e vitit 2022 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës lidhur me numrin e rasteve penale dhe civile në regjistrin që posedon ky institucion për këtë vit.

Të dhënat tregojnë se në mbarë vendin gjykatat kanë arritur të zgjidhin vetëm 20% të rasteve të kontesteve të punës, ndërsa pjesa tjetër kanë mbetur të pazgjidhura. Në vitin 2022 në gjykata ishin gjithsej 463 lëndë të kontesteve të punës, prej të cilave brenda vitit u zgjidhën vetëm 88 raste, ndërsa 375 raste mbetën të pazgjidhura. Tabela e rasteve tregon që në disa gjykata nuk janë zgjidhur as 10% e rasteve të cilat janë konteste në punë.

<sup>15</sup> Raporti vjetor i Inspektoratit të Punës për vitin 2021, <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf>

## Rasti 1

Rasti i parë të cilin BIRN e ka analizuar është një rast i vdekjes së punëtorit në rajonin e Mitrovicës. Gjatë analizimit të rastit, BIRN ka analizuar mënyrën se si është dënuar punëdhënësi për shkeljet e kryera nga Inspektorati i Punës.

Data / Ngjarja kritike	04.11.2022
Pasoja: Vdekje	Rënia në kokë e zinxhirit të vinçit me të cilin bartej betoni
Shkeljet e konstatuara dhe gjoba e shqiptuar për secilën shkelje	Ligji për siguri dhe shëndet në punë - shkelje Neni 6 - 3,000 euro Neni 7 - 3,500 euro Neni 13 - 3,000 euro Neni 14 - 3,000 euro Neni 16 - 2,500 euro Neni 20, par.1,2 - 3,000 euro Neni 22, par. 2 - 2,000 euro
Totali i gjobës	10.000€
Gjoba e paraparë sipas Ligjit për siguri dhe shëndet në punë për secilën pikë të konstatuar nga Inspektorati i Punës	Cenimi i nenit 6 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 10 mijë euro) Cenimi i nenit 7 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 35 mijë euro) Cenimi i nenit 13 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 35 mijë euro) Cenimi i nenit 14 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 25 mijë euro) Cenimi i nenit 16 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 25 mijë euro) Cenimi i nenit 20 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 20 mijë euro) Cenimi i nenit 22 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 20 mijë euro)
Ankesa e punëdhënësit ndaj gjobës	Vendimi i shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës
22.03.2023	31.05.2023

Analizimi i këtij rasti tregon se punëtori i vdekur në vendin e punës nuk ka qenë i trajnuar në fushën e sigurisë në punë, nuk ka qenë i trajnuar për punën të cilën e ka bërë dhe nuk ka poseduar certifikatë mjekësore. Punëdhënësi nuk i ka mirëmbajtur mjetet e punës dhe nuk i ka shikuar nëse ato janë në gjendje të rregullt. Punëdhënësi nuk ka pasur dokument të vlerësimit të rrezikut ndërsa punëtori nuk ka pasur helmë në kokë e as uniformë pune. \*Brenda 5 viteve të fundit, tek ky punëdhënësi kanë ndodhur 3 aksidente me fatalitet.

Dosja konstaton se ndaj subjektit në secilën prej pikave biznesi është ndëshkuar mbi minimumin e gjobave të parapara me Udhëzuesin e Inspektoratit. Kjo gjobë prej 20 mijë eurosh në total është vërtetuar edhe nga shkalla e dytë, gati dy muaj pasi është ankuar subjekti i gjobitur.



## Rasti 2

Rasti i dytë të cilin BIRN e ka analizuar është një rast i aksidentit në vendin e punës në të cilin një punëtor ka thyer këmbën. BIRN ka analizuar mënyrën se si është dënuar punëdhënësi për shkeljet e kryera.

Data e inspektimit	03.03.2022
Shkeljet e konstatuara nga Inspektorati i Punës	1.Neni 6 i Ligjit për siguri dhe shëndet në punë 2.Neni 10 i Ligjit të punës
Totali i gjobës	1.200€
Gjoha e paraparë sipas udhëzimit administrativ për përcaktimin e gjobave	Cenimi i nenit 10 të Ligjit të punës (100 deri 6 mijë euro) Cenimi i nenit 6 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 10 mijë euro)
Ankesa e punëdhënësit ndaj gjobës	Vendimi i shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës
Evidentohet në dosje që ankesa ka qenë në afat ligjor	17.10.2022

Në këtë subjekt punëdhësi ka bërë shkelje të dispozitave që kanë të bëjnë me kontratën e punës dhe detyrime të përgjithshme për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Inspektorati i Punës ka shqiptuar gjoba mbi minimumin e paraparë sipas udhëzimit administrativ.

## Rasti 3

Rasti i tretë i trajtuar nga ana e organit të shkallës së dytë ka të bëjë me një subjekt i cili kishte cenuar rregullat për siguri dhe shëndet në punë në rajonin e Malishevës. Këtij subjekti inspektori i punës ia ka ndaluar punimet për shkak të rrezikimit të punëtorëve në vendin e punës. Vendimi është vërtetuar edhe nga komisioni i shkallës së dytë.

Data e inspektimit	26.03.2022
Shkeljet e konstatuara nga Inspektorati i Punës	1. Neni 14 i Ligjit për siguri dhe shëndet në punë 2. Neni 23 i Ligjit për siguri dhe shëndet në punë
Masa e shqiptuar	Ndalimi i punimeve përkohësisht
Ankesa e punëdhënësit ndaj gjobës	Vendimi i shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës
Evidentohet në dosje që ankesa ka qenë në afat ligjor	21.11.2022

Te ky subjekt juridik, Inspektorati i Punës ka ndaluar përkohësisht punimet meqë punëdhënësi nuk kishte të vendosura pajisjet personale mbrojtëse, nuk ka pasur vlerësim të rrezikut dhe as trajnim të punëtorëve. Nuk ka të dhëna nëse subjektit i është shqiptuar masë tjetër përveç ajo e ndalimit të përkohshëm të punimeve.

#### Rasti 4

Në këtë subjekt punëdhësi ka bërë shkelje të dispozitave që kanë të bëjnë me kontratën e punës dhe detyrime të përgjithshme për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Inspektorati i Punës ka shqiptuar gjoba mbi minimumin e paraparë sipas udhëzimit administrativ. Në këtë subjekt punëdhësi ka bërë shkelje të dispozitave që kanë të bëjnë me kontratën e punës dhe detyrime të përgjithshme për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Inspektorati i Punës ka shqiptuar gjoba mbi minimumin e paraparë sipas udhëzimit administrativ.

Data e inspektimit	15.06.2022
Shkeljet e konstatuara	1.Neni 13, pika 1 dhe 1.6 i Ligjit për siguri dhe shëndet në punë Nenet 67 dhe 47 të Ligjit për të huajt
Totali i gjobës	10.000€
Gjoba e paraparë sipas udhëzimit administrativ për përcaktimin e gjobave	Cenimi i nenit 13 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 35 mijë euro)
Ankesa e punëdhënësit ndaj gjobës	Vendimi i shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës
N/A	20.02.2023

Përveq punësimit të punonjësve të huaj të cilët nuk kanë pasur leje qëndrimi si kusht për të punuar në Kosovë, ky punëdhës nuk u kishte bërë as vlerësimin mjekësor për punën që e kanë kryer.

#### Rasti 5

BIRN në rastin e pestë ka analizuar një aksident pune i ndodhur në shkurt të vitit 2023 në rajonin e Ferizajt. Punëdhënësi kishte bërë shkelje të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, ku gjoba e shqiptuar prej 1 mijë e 99 euro ishte vërtetuar edhe nga komisioni i shkallës së dytë të Inspektoratit.

Data e inspektimi të aksidentit	25.02.2023
Shkeljet e konstatuara	1. Neni 11 i Ligjit të punës 2. Neni 22 i Ligjit për siguri dhe shëndet në punë 3. Neni 20 i Ligjit për siguri dhe shëndet në punë 4. Neni 6 i Ligjit për siguri dhe shëndet në punë

<b>Totali i gjobës</b>	1 mijë e 900 euro
<b>Gjoba e paraparë sipas udhëzimit administrativ për përcaktimin e gjobave</b>	Cenimi i nenit 11 të Ligjit të punës (100 deri 6 mijë euro) Cenimi i nenit 22 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 20 mijë euro) Cenimi i nenit 20 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 20 mijë euro) Cenimi i nenit 6 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë (500 deri 10 mijë euro)
<b>Ankesa e punëdhënësit ndaj gjobës</b>	Vendimi i shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës
<b>19.05.2023</b>	<b>27.09.2023</b>

Në rastin V, inspektimi nga Inspektorati i Punës ka qenë i natyrës së jashtëzakonshme - rast i aksidentit. Inspektorët kanë shqiptuar gjobë në vlerë prej 1,900 euro pasi kanë gjetur shkelje për kontratën e punës dhe rregulla nga dispozita për siguri dhe shëndet në punë. Punëdhënësi nuk kishte ndërmarrë masa për të mundur vend të sigurtë pune.

1. Për shkeljen nga kontrata e punës, sipas udhëzimit administrativ, Inspektorati ka shqiptuar minimumin e gjobës (100 euro) të paraparë me udhëzimin administrativ 07/2012.

2. Për shkeljet nga Ligji për siguri dhe shëndet në punë, Inspektorati në këtë rast 1 shkelje e ka gjobitur në minimum (500 euro), dhe në 2 raste ka kaluar minimumin duke shqiptuar gjobë prej 600 dhe 700 euro.

## Rasti 6

BIRN në rastin e fundit ka analizuar një aksident në vend pune në rajonin e Skenderajt, në të cilin një punëtor kishte pësuar lëndime trupore. Në këtë rast punëdhënësi kishte prezantuar certifikatën e trajnimit të punëtorit një ditë pasi kishte ndodhur aksidenti.

<b>Data e inspektimi të aksidentit</b>	06.04.2022
<b>Shkeljet e konstatuara</b>	1. Neni 20 i Ligjit për siguri dhe shëndet në punë 2. Neni 23 i Ligjit për siguri dhe shëndet në punë
<b>Totali i gjobës</b>	2,000 euro
<b>Gjoba e paraparë sipas udhëzimit administrativ për përcaktimin e gjobave</b>	Cenimi i nenit 20 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë 500 deri 20 mijë euro Cenimi i nenit 23 të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë 500 deri 20 mijë euro
<b>Ankesa e punëdhënësit ndaj gjobës</b>	Vendimi i shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës
<b>07.06.2022</b>	<b>09.12.2022</b>

Inspektorët e punës kanë shqiptuar gjobë ndëshkuese mbi kufirin e minimumit (500 euro), duke dhënë gjoba nga 1,000 euro për mostrajnim paraprak të punëtorit të aksidentuar dhe mosnjohim të aksidentit të ndodhur.

Sipas Ligjit për Inspektoratin e Punës 2002/9, kundër vendimit të inspektorit të punës për masën ndëshkuese mund të bëhet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit, drejtuar shkallës së dytë. Ndërsa, autoriteti i Inspektoratit të Punës është i obliguar që në afat prej 60 ditësh të vendosë sipas ankesës së ushtruar në vendimin e inspektorit të punës.

Nga 6 vendimet e analizuar të Inspektoratit të Punës, ky i fundit vetëm në 1 rast ka vendosur brenda afatit ligjor prej 60 ditësh që nga data e ankesave të palëve (subjekteve të gjobitura).

Në të gjitha vendimet e analizuar, të dala nga shkalla e dytë e këtij organi, janë refuzuar ankesat e subjekteve dhe janë vërtetuar vendimet e shkallës së parë. Në këto raste nuk ka pasur rritje apo ndryshim të dënimit.

Gjatë analizimit vërehet një mosunifikim i gjobave të shqiptuara për shkelje të njëjta të punëdhënësit. Të dhënat e BIRN tregojnë që Inspektorati i Punës nuk ka ndonjë udhëzues që do të përcaktonte mënyrën e përllogaritjes dhe vlerësimit të shkeljeve.

Në mungesë të një dokumenti të tillë, Inspektorati i Punës shqipton gjobat pa një standard të unifikuar. Gjithashtu, analizimi i të dhënave tregon se shkalla e dytë përpos që ka shërbyer si konfirmues i vendimeve, nuk ka ndërmarrë hapa që të unifikojë politikën ndëshkimore duke ulur apo rritur gjoba për situatat e njëjta ose të ngjashme.

## 4. Performanca e gjyqësorit në trajtimin e rasteve civile

Gjatë hartimit të këtij raporti, BIRN ka trajtuar të dhënat statistikore të rasteve civile për të ofruar një pasqyrë të qartë mbi numrin e rasteve që gjykatat i kanë në punë dhe seriozitetin e trajtimit të tyre. Analiza më e thellë është bërë te rastet penale, ku përpos analizimit të statistikave, BIRN ka audituar edhe lëndët të cilat janë trajtuar nga gjykatat për të matur performancën e institucioneve të drejtësisë në hetim dhe gjykim të aksidenteve në punë.

### 4.1 Ngecjet në trajtimin e çështjeve civile

Kontestet e punës trajtohen në fazën e fundit në gjykatë. Sipas ligjit, zgjidhja e kontesteve të punës është prioritet për gjykatat, mirëpo të dhënat e siguruar nga BIRN tregojnë që gjykatat kanë injoruar plotësisht këtë parim.

BIRN ka marrë të dhënat e vitit 2022 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës lidhur me numrin e rasteve penale dhe civile në regjistrin që posedon ky institucion për këtë vit.

Të dhënat tregojnë se në mbarë vendin gjykatat kanë arritur të zgjidhin vetëm 20% të rasteve të kontesteve të punës, ndërsa pjesa tjetër kanë mbetur të pazgjidhura. Në vitin 2022 në gjykata ishin gjithsej 463 lëndë të kontesteve të punës, prej të cilave brenda vitit u zgjidhën vetëm 88 raste, ndërsa 375 raste mbetën të pazgjidhura. Tabela e rasteve tregon që në disa gjykata nuk janë zgjidhur as 10% e rasteve të cilat janë konteste në punë.

Gjykata	Numri I rasteve civile (Kthim në vend pune)	Raste të zgjidhura	Raste të pazgjidhura
Prishtinë	268	47	221
Podujevë	8	1	7
Graçanicë	5	1	4
Lipjan	15	2	13
Drenas	10	1	9
Gjilan	6	4	2
Kamenicë	3	1	2
Viti	3	0	3
Novobërdë	3	2	1
Prizren	23	2	1
Suharekë	5	4	1
Dragash	2	1	1
Mitrovicë	22	8	14
Leposaviq	1	0	1
Vushtrri	1	0	1
Zubin Potok	1	0	1
Skenderaj	4	2	2
Gjakovë	9	1	8
Malishevë	25	0	25
Rahovec	1	0	1
Pejë	11	2	9
Istog	5	3	2
Klinë	3	2	1
Deçan	2	0	2
Ferizaj	24	3	21
Kaçanik	1	0	1
Shtërpçë	2	1	1

**Tabela 4.1.1. Trajtimi i rasteve civile nga gjykata**



## 4.2 Ngecjet në trajtimin e rasteve penale

BIRN ka pranuar të dhëna nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për rastet penale të trajtuara në vitin 2022 nga të gjitha gjykatat e Kosovës për veprën penale - "Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës". Në nivel vendi janë trajtuar gjithsej 105 raste.

Edhe në trajtimin penal performanca e sistemit të drejtësisë nuk është e duhura për shkak se më pak se 50% e lëndëve janë përfunduar. Sipas të dhënave, nga 105 raste në total, vetëm 43 prej tyre janë zgjidhur.

Përpos performancës së ulët në trajtim të rasteve, gjykatat nuk kanë shqiptuar dënime me burg për kryesit e veprave të lartpërmendura. Sipas të dhënave, më pak se 10% e dënimeve janë dënime me burgim efektiv. Nga 43 raste të zgjidhura janë shqiptuar 6 dënime me burgim, 21 dënime me gjobë, dhe 7 dënime me kusht, ndërsa në 3 raste të akuzuarit janë liruar nga akuzat.

Gjykata (dep. i përgjithshëm)	Numri i rasteve	Të zgjidhura	Të pazgjidhura	Dënimi
Prishtinë	18	5	13	2 me kusht, 1 me gjobë 1 gjobë dhe 1 burgim
Podujevë	4	3	1	2 gjobë 1 burgim
Graçanicë	1	0	1	/
Lipjan	3	2	1	1 dënim me kusht 1 dënim me gjobë
Drenas	4	3	1	/
Gjilan	8	5	3	1 dënim me kusht, 1 N/A 2 me gjobë dhe me kusht
Kamenicë	0	0	0	0
Viti	3	1	2	1 gjobë
Novobërdë	0	0	0	0
Prizren	14	4	10	2 gjobë, 1 me kusht, 1 NA
Suharekë	1	0	1	/
Dragash	1	1	0	1 është liruar nga dënimi
Mitrovicë	0	0	0	/
Leposaviq	0	0	0	/
Vushtrri	2	1	1	1 dënim me burg
Zubin Potok	0	0	0	/
Skenderaj	0	0	0	/
Gjakovë	6	5	1	4 me gjobë 1 me kusht
Malishevë	6	3	3	2 gjobë 1 burgim
Rahovec	7	2	5	1 dënim me kusht 1 me gjobë
Pejë	8	2	6	1 lirues 1 N/A
Istog	3	1	2	1 gjobë
Klinë	1	0	1	/
Deçan	3	2	1	1 gjobë, 1 N/A
Ferizaj	11	4	7	4 dënime me gjobë
Kaçanik	5	1	4	N/A
Shtërpcë	0	0	0	/

Gjykata (dep. i krimeve të rënda)	Numri i rasteve	Të zgjidhura	Të pazgjidhura	Dënimi
Prishtinë	3	3	0	1 rast – 4 të dënuar, 2 me burg, 2 me gjobë 1 rast – 4 të dënuar me burg 1 rast – 1 burg 1 gjobë
Gjilan	1	1	0	2 gjobë 1 burgim

Në Departamentin për krime të rënda janë 4 raste të përfundura, prej të cilave janë 10 persona të dënuar. Sipas të dhënave nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ky departament ka shqiptuar 7 dënime me burg dhe 3 dënime me gjobë.

### 4.3 Performanca e prokurorisë në trajtimin e rasteve

Për vitet 2021 dhe 2022 si dhe për periudhën janar-qershor 2023 numri i kallëzimeve penale të pranuar nga prokuroritë themelore në nivel vendi është **237**. Nga ky numër, 25% e rasteve janë mbyllur në mungesë provash, ndërsa në vetëm **131 raste janë ngritur** aktakuza.

Sipas të dhënave të lartshënuara, ka një trend të rritjes së kallëzimeve penale të pranuar gjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023.

Numri i aktakuzave të ngritura në vitin 2021 në nivel vendi është 53, në vitin 2022 është 46 dhe për periudhën janar - qershor 2023 është 32. Por, sipas këtyre të dhënave, për dallim nga trendi në rritje për pranimin e kallëzimeve penale nga prokuroritë themelore në vend, trendi është në rënie kur është çështja të ngritja në aktakuzë e këtyre kallëzimeve penale gjatë tri viteve të fundit.

Prokuroria Themelore e Mitrovicës në periudhën (2021, 2022, janar - qershor 2023) **nuk ka asnjë aktakuzë të ngritur**.

Rajoni me numrin më të madh të kallëzimeve penale të pranuar për vitin 2021, 2022 dhe 6-mujorin e 2023 është Prishtina me 66 kallëzime në total, prej tyre 39 janë aktakuza të ngritura.

Pejë	Periudha kohore	Kallëzime penale të pranuar	Të hedhura poshtë	Pushim të hetimeve	Aktakuza të ngritura	Në proces hetimor
	2021	1	1	0	0	0
	2022	7	3	0	2	2
	6 mujori 2023	5	0	0	3	2

Prishtinë	Periudha kohore	Kallëzime penale të pranuar	Të hedhura poshtë	Pushim të hetimeve	Aktakuza të ngritura	Në proces hetimor
	2021	21	2	3	16	0
	2022	21	0	1	12	0
	6 mujori 2023	24	1	1	11	0

Gjilan	Periudha kohore	Kallëzime penale të pranuara	Të hedhura poshtë	Pushim të hetimeve	Aktakuza të ngritura	Në proces hetimor
	2021	5	0	0	5	0
	2022	5	0	2	3	0
	6 mujori 2023	8	0	3	4	1

Prizren	Periudha kohore	Kallëzime penale të pranuara	Të hedhura poshtë	Pushim të hetimeve	Aktakuza të ngritura	Në proces hetimor
	2021	15	2	2	13	0
	2022	13	5	1	7	0
	6 mujori 2023	12	2	3	8	0

Ferizaj	Periudha kohore	Kallëzime penale të pranuara	Të hedhura poshtë	Pushim të hetimeve	Aktakuza të ngritura	Në proces hetimor
	2021	10	0	1	9	0
	2022	14	1	1	10	2
	6 mujori 2023	8	2	0	3	3

Mitrovicë	Periudha kohore	Kallëzime penale të pranuara	Të hedhura poshtë	Pushim të hetimeve	Aktakuza të ngritura	Në proces hetimor
		11	7	0	13	4

Gjakovë	Periudha kohore	Kallëzime penale të pranuara	Të hedhura poshtë	Pushim të hetimeve	Aktakuza të ngritura	Në proces hetimor
	2021	16	4	2	10	0
	2022	27	13	0	12	0
	6 mujori 2023	14	10	0	4	0

**Tabela 4.3. Rrjedha e kallëzimeve penale në Prokurorinë e Shtetit**

### 4.3.1 Trajtimi i rasteve në rajonin e Gjakovës

Të dhënat nga analizimi i rasteve në Gjakovë tregojnë se kallëzimet penale në dy raste nuk janë dorëzuar me kohë ndërsa procesi i hetimeve në disa raste ka nisur me vonesa të cilat kanë zgjatur deri në një vit.

Gjykata Themelore Gjakovë	Rasti 1	Rasti 2	Rasti 3	Rasti 4	Rasti 5
Data e aksidentit	31.05.2020	9.11.2022	22.11.2019	03.10.2020	02.04.2020
Policia/ Prokuroria	Dëshmitarë - Këqyrje të vendit të ngjarjes - Forenzika - Ekspertiza mjeko-ligjore				
Kallëzimi penal me kohë	JO	PO	JO	PO	PO
Fillimi i hetimeve	19.10.2020	21.01.2023	18.06.2020	Brenda muajit	04.11.2020
Aktakuza	04.11.2020	20.04.2023	18.09.2020	16.10.2020	16.11.2020
Vepra Penale	Neni358, par. 5 3 dhe 2	Neni358, par. 5 3 dhe 2	Neni358, par. 5 3 dhe 2	Neni358, par. 5 3 dhe 2	Neni358, par. 5 3 dhe 2
Dënimi i paraparë	Deri në 5 vite	Deri në 5 vite	Deri në 5 vite	Deri në 5 vite	Deri në 5 vite
Dënimi i shqiptuar	12.3.2021 10 muaj burg me kusht	08.06.2023 180 ditë burgim i zv. gjobë 2,500	24.02.2021 8 muaj dënim me kusht	08.12.20 7 muaj dënim me kusht	20.04.21 180 ditë burgim, zv. me gjobë 3,000 euro
Rrethana lehtësuese	3	3	2	2	3
Rrethanat rënduese	2	Nuk gjeti	Nuk gjeti	2	1
Inspektorati	500 euro gjobë	900 euro	N/A	N/A	500 euro gjobë

Tabela 4.3.1. Trajtimi i rasteve në rajonin e Gjakovës

Sipas të dhënave, aktvendimi për fillim të hetimeve është nxjerrë brenda muajit vetëm në një rast, ndërsa në rastet e tjera vonesat për fillimin e hetimeve kanë qenë prej 4 muaj deri në 1 vit. Në situatat e tilla ku prokuroria ka vonesa në fillimin e hetimeve, provat e rëndësishme mund të zhduken ose dëshmitarët mund të ndryshojnë deklaratat e tyre. Në rastet e hulumtuara, dënimet janë të ulëta dhe nuk përkojnë me situatën që është paraqitur në aktakuzë.

Në 2 raste në Gjakovë, punëtorët kanë kërkuar kompensim për lëndimet e tyre dhe i janë bashkëngjitur ndjekjes penale të punëdhënësve.

Në hulumtimin e këtyre rasteve të trajtuara nga gjykata, ku janë dënuar punëdhënësit në rastet e aksidenteve dhe lëndimeve në punë, 3 dënime kanë qenë me burgim me kusht, e në 2 të tjera burgimi ishte zëvendësuar me gjobë.

Ajo çfarë ka dominuar gjatë hulumtimit është se asnjë nga punëdhënësit nuk e kishte pranuar veprën penale në fazën e hetimeve nga Policia apo kur ishin marrë në pyetje nga prokurori. Por situata kishte ndryshuar në gjykatë. Aty punëdhënësit deklarohen se ndihen fajtorë dhe se kërkojnë falje për veprimet që (nuk) i kanë ndërmarë.

Sa u përket veprimeve hetimore të Policisë, dëshmitarët janë thirrur, përfshirë edhe inspektori i punës, familjarë e ekspertë mjekoligjorë për t'i konstatuar lëndimet e rënda trupore që kishin pësuar punëtorët në vendin e tyre të punës.

Në cilësinë e dëshmitarëve të parë të thirrur dhe të intervistuar janë kolegët e punës, të cilët përshkruanin momente kur kishin parë aksidentin apo dëgjuar britmat e kolegëve të tyre në vendin e ngjarjes. Edhe njësitë e forenzikës, në të gjitha rastet kishte dalë në vendet e ngjarjes, duke gjetur dëshmi sikurse që janë njollat e gjakut.

### 4.3.2 Trajtimi i rasteve në rajonin e Ferizajt

Gjetjet e rasteve në Ferizaj tregojnë se kallëzimet penale nga Policia ishin dërguar me vonesë në Prokurorinë e Shtetit.

Në asnjërin prej rasteve, hetimet e Prokurorisë nuk kishin filluar menjëherë pas ngjarjeve por me vonesa serioze deri në 1 vit pas incidentit

Gjykata Themelore Ferizaj	Rasti 1	Rasti 2	Rasti 3	Rasti 4
Data e aksidentit	09.12.2020	04.10.2021	22.11.2020	03.10.2020
Policia/ Prokuroria	Dëshmitarë - Këqyrje të vendit të ngjarjes Forenzika - Ekspertiza mjekoligjore			
Kallëzimi penal me kohë	JO	JO	JO	PO
Fillimi i hetimeve	01.04.2021	06.09.2022	Shkurt, 2021	Mars, 2021
Aktakuza	22.04.2021	21.09.2022	04.03.2021	13.04.2022
Seanca	21.09.2021	08.03.2023	19.05.2021	18.05.2021
Dënimi i shqiptuar	12.3.2021 10 muaj burg me kusht	08.06.2023 180 ditë burgim i zv. gjobë 2,500	24.02.2021 8 muaj dënim me kusht	08.12.20 7 muaj dënim me kusht
Rrethanat lehtësuese	3	3	4	4
Rrethanat rënduese	2	2	2	3
Inspektorati	N/A	N/A	N/A	N/A

Tabela 4.3.2. Trajtimi i rasteve në rajonin e Ferizajt

Edhe pse katër punëtorët e aksidentuar në Ferizaj nuk kishin kontrata të punës, punëdhënësit shpëtuan vetëm me dënime me gjobë.

Aktakuzat e ngritura në Ferizaj janë të shpejta dhe sipas të dhënave janë ngritur nga prokurorët në afate prej më pak se një muaj hetimesh të realizuara.

Të gjitha rastet e Ferizajt kanë përfunduar me dënime me gjobë dhe me kusht anipse për veprat e tyre parashiheshin dënime deri në 10 vite.



Nga rastet e analizuara në Gjykatën e Ferizajt, në 3 raste dënimi me burgim është zëvendësuar me gjobë, kurse 1 dënim ka qenë me gjobë në vlerë prej 2 mijë eurosh.

Në rastin ku Gjykata ka shpallur dënim me burgim prej 3 muajsh dhe të njëjtin dënim e ka zëvendësuar me gjobë, si rrethanë lehtësuese Gjykata mori faktin se kryesi i veprës penale nuk ishte i martuar. “Beqaria” nuk figuron si rrethanë lehtësuese me rastin e zbutjes së dënimit, as në Udhëzuesin e Politikës Ndëshkimore.<sup>16</sup>

Në një rast punëdhënësi ka bërë marrëveshje jashtëgjyqësore me punëtorin me 5 mijë euro kompensim, të cilin Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit e mori si rrethanë lehtësuese.

Në të gjitha rastet Inspektorati ka konstatuar shkeljet por nuk ka evidencë në lëndët sa i përket gjobës së shqiptuar.

### 4.3.3 Trajtimi i rasteve në rajonin e Prizrenit

Rastet e trajtuara nga kjo Gjykatë shquhen për vonesa nga ana e Prokurorisë, duke filluar nga ndodhia e ngjarjeve kritike deri në ngritjen e aktit akuzues. Kurse Policia vetëm në dy raste i'a ka dorëzuar kallëzimet penale me kohë Prokurorisë.

Gjykata Themelore Prizren	Rasti 1	Rasti 2	Rasti 3	Rasti 4	Rasti 4
Ngjarja kritike	18.06.2022	17.09.2020	25.11.2020	19.08.2019	10.10.2022
Policia/ Prokuroria	Dëshmitarë - Këqyrje të vendit të ngjarjes - Forenzika - Ekspertiza mjekoligjore				
Kallëzimi penal me kohë	PO	JO	JO	JO	PO
Fillimi i hetimeve	04.08.2022	11.02.2021	01.03.2021	14.02.2020	27.12.2022
Aktakuza	30.08.2022	17.03.2021	02.04.2021	26.02.2020	24.01.2023
Seanca	21.09.2021	08.03.2023	19.05.2021	18.05.2021	18.05.2021
Vepra penale	Neni 358, par.2 dhe 3	Neni 358, par. 5, 3 dhe 2.	Neni 358, par. 5 dhe 2	Neni 358, par. 5 dhe 2	Neni 358, par. 5, 3 dhe 2.
Dënimi i paraparë	Deri në 3 vite	Deri në 5 vite	Deri në 5 vite	Deri në 5 vite	Deri në 5 vite
Rrethanat rënduese	05.12.22 Dënim me kusht 1 vit burg (2 verifikim)	03.02.23 Dënim me burg 1 vit efektiv	11.06.22 Dënim me gjobë 1,500 euro	30.7.21. 2,000 euro 2.6 muaj burgim (zv. me gjobë 1,300 euro)	20.3.23 Gjobë 460 euro
Rrethanat lehtësuese	3	2	4	Marrëveshje për pranim të fajësisë	6
Rrethanat rënduese	Nuk gjeti	4	1	Marrëveshje për pranim të fajësisë	1
Inspektorati	500	/	/	500	1200

Tabela 4.3.3. Trajtimi i rasteve në rajonin e Prizrenit

<sup>16</sup> [https://supreme.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore\\_Shkurt%202018.pdf](https://supreme.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf)

Nga 5 rastet e analizuara, të trajtuara nga Gjykata Themelore në Prizren, 1 rast është në rigjykim, në të cilin është shqiptuar dënimi me burgim efektiv prej 1 viti, kjo pasi që Apeli e ka kthyer këtë rast duke aprovuar ankesën e personit të dënuar.

Nga 5 raste gjyqësore, vetëm në një rast punëtori i është bashkëngjitur ndjekjes penale dhe ka kërkuar kompensim për lëndimet e pësuar.

Gjykata Themelore e Prizrenit kishte shqiptuar gjobën më të ulët nga të gjitha gjykatat e tjera, duke marrë parasysh gjithsej 6 rrethana lehtësuese e vetëm 1 rënduese.

Në një rast në të cilin punëtori kishte pësuar lëndime të rënda trupore (e kishte këputur gishtin e madh të dorës së djathtë) në vendin e punës, Gjykata nuk kishte gjetur asnjë rrethanë rënduese.

Prokuroria në një rast gjyqësor e kishte kundërshtuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari për shkak se pranimi i fajësisë nuk ishte përshtatur me gjendjen faktike të përshkruar në aktakuzë.

Pranimin e fajësisë në këtë rast nuk e kishte aprovuar as Gjykata deri kur Prokuroria e kishte ndryshuar dispozitivin e aktakuzës.

Në të gjitha rastet, Gjykata ka marrë parasysh rrethanat personale të të akuzuarve si rrethanat lehtësuese, përfshirë këtu faktin që kanë qenë prindër, pranimin e fajësisë, kujdesin që e kanë treguar lidhur me shërimin e të lënduarëve e deri te sjellja e tyre korrekte në Gjykatë.

Në një rast, punëdhënësi i akuzuar ka treguar në Gjykatë se nuk ka pasur njohuri se punëtorët duhet të jenë të pajisur me certifikata shëndetësore. Në një rast tjetër, Prokuroria ka arritur marrëveshje me të akuzuarin për pranim të fajësisë, marrëveshje kjo e pranuar nga Gjykata 10 ditë pas fillimit të hetimeve dhe 2 ditë pas ngritjes së aktakuzës.

#### **4.3.4 Trajtimi i rasteve në rajonin e Gjilanit**

Zvarritja e proceseve gjyqësore shihet të jetë si dukuri e shpeshtë. Nisur nga kjo, në Gjykatën Themelore të Gjilanit një rast është zvarritur për 2 vite, duke qenë në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, ku shqyrtimi nuk mund të zgjasë më shumë se 90 ditë. Nuk ka evidencë në dosjen e rastit në fjalë se gjyqtari ka nxjerrë aktvendim për vazhdim të shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 314 të këtij Kodi.

Gjykata themelore Gjilan	Rasti 1	Rasti 2	Rasti 3
Data e aksidentit	26.12.2016	20.11.2018	09.05.2015
Policia/ Prokuroria	Dëshmitarë- Këqyrje të vendit të ngjarjes Forenzika		
Kallëzimi penal me kohë	JO	JO	JO
Fillimi i hetimeve	10.03.2017	N/A	10.02.2017
Aktakuza	28.04.2017	13.02.2019	19.04.2017
Vepra penale	Neni 367, par. 5 dhe 3	Neni 367 par. 2	Neni 367, par. 2, 5 dhe 3
Dënimi i paraparë	Deri në 5 vite	6 muaj 5 vite	Deri në 5 vite
Vepra penale	Neni 367, par. 5 dhe 3	Neni 367 par. 2	Neni 367, par. 2, 5 dhe 3
Dënimi i shqiptuar	12.2.20 Gjobë 600 euro	14.01.21 Gjobë 3,000 euro	20.02.20 Firma gjobë 2 mijë euro Pronari 6 muaj burg zëvendësim 2,000 euro
Rrethanat lehtësuese	1	7	2
Rrethanat rënduese	2	1	3
Inspektorati	N/A	Ka konstatuar shkeljet	Ka konstatuar shkelje

**Tabela 4.3.4. Trajtimi i rasteve në rajonin e Gjilanit**

Nga 3 dosjet e analizuar në Gjykatën Themelore të Gjilanit, një rast i shqiptimit të dënimit me gjobë është apeluar nga Prokuroria, ankesa e së cilës është refuzuar dhe gjoba është vërtetuar.

Në asnjë nga këto raste të trajtuara, kallëzimet penale nuk janë ngritur dhe dorëzuar me kohë.

Në një rast, kjo Gjykatë nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese.

Në 2 raste në rajonin e Gjilanit punëtorët i janë bashkangjitur ndjekjes penale dhe kanë kërkuar kompensim.

Një rast është raportuar nga bashkëshortja e të aksidentuarit 1 vit më vonë, kurse pas 5 vitesh mori fjalën e fundit nga Gjykata.

Për një rast në këtë Gjykatë janë mbajtur 9 seanca nga gushti i vitit 2018 deri në shkurt të vitit 2020.

### 4.3.5 Trajtimi i rasteve në rajonin e Prishtinës

BIRN ka analizuar 3 dosje të Gjykatës Themelore të Prishtinës në të cilat janë shqiptuar vetëm dënime me kusht e dënimi me burgim është zëvendësuar me gjobë për dy të akuzuar.

Të dhënat tregojnë se kohëzgjatja e hetimeve në prokurori është e lartë dhe ka vonesa në ngritjen e aktakuzave për aksidentet në punë.

Gjykata Themelore Prishtinë	Rasti 1	Rasti 2	Rasti 3
Data e aksidentit	26.02.2021	23.12.2020	14.10.2022
Policia/ Prokuroria	Ekspertiza mjekoligjore		
Aktakuza	14.02.2022	28.06.2021	02.11.2022
Vepra penale	Neni 358 par. 2 dhe 4	Neni 358 par. 2	Neni 358 par. 5, 3 dhe 2
Dënimi i paraparë	1 deri 10 vite	6 muaj - 5 vjet	Deri në 5 vite
Dënimi i shqiptuar	19.12.2022 Dënim me kusht 1 vit	10.10.22 Burg 6 muaj i zv. me 2,000 euro	23.12.2022 Burg 6 muaj i zv. me gjobë 2 mije euro
Rrethanat lehtësuese	4	5	4
Rrethanat rënduese	Nuk gjeti	2	2
Inspektorati	Ka konstatuar shkeljet	Ka konstatuar shkeljet	Ka konstatuar shkeljet

Tabela 4.3.5. Trajtimi i rasteve në rajonin e Prishtinës

Në një rast, Prokuroria ka arritur marrëveshje me personin e akuzuar 9 muaj pasi ia kishte ngritur aktakuzën. Gjykata në këtë rast nuk gjeti asnjë rrethanë rënduese.

Në rastet e trajtuara nga kjo gjykatë ka vonesa të mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore që nga ngritja e aktakuzave. Në këto raste nuk ka evidencë nëse kallëzimet penale janë ngritur dhe dorëzuar me kohë, meqenëse janë analizuar vetëm aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata.

Rrethanat lehtësuese të cilat janë marrë parasysh nga kjo Gjykatë më së shumti janë pranimi i fajësisë, rrethanat personale, premtimi se nuk do ta kryejnë më veprën penale e pendimi.

Rrethana rënduese rëndom mori shkallën e rrezikshmërisë dhe atë të përgjegjësisë penale.

## 4.3.6 Trajtimi i rasteve në rajonin e Pejës

Në rajonin e Pejës janë analizuar 5 raste në të cilat nuk është shqiptuar asnjë dënim me burg efektiv. Dënimet në këto raste janë dënime me gjobë.

Gjykata Themelore Pejë	Rasti 1	Rasti 2	Rasti 3	Rasti 4	Rasti 5
Ngjarja kritike	14.03.22	26.11.19	02.06.20	10.06.21	28.08.20
Policia/ Prokuroria	Ekspertiza mjekoligjore / Fotografi nga vendi i ngjarjes				
Aktakuza	28.04.22	08.12.20	22.02.21	28.09.21	18.12.20
Vepra penale	Neni 358 par. 5 dhe 2	Neni 358 par. 5 dhe 2	Neni 358 par. 3 dhe 5	Neni 358 par. 2	Neni 358, par. 5,3 dhe 1
Dënimi i paraparë	Deri në 5 vite	Deri në 5 vite	Deri në 5 vite	6 muaj deri në 5 vite	Deri në 5 vite
Dënimi i shqiptuar	19.9.23 6 muaj burgim i zv. me 1,200 euro	25.5.23 Pronari 5,000 euro Personi përgjegjës 2,500 euro	20.12.21 Personi juridik 1,000 euro Personi përgjegjës 6 muaj burg 500 euro zv.	1.6.23 1. 6 muaj burg zv. me 600 euro gjobë 2. 6 muaj i zv. me 600 euro gjobë	29.1.21 Dënim me kusht 6 muaj
Rrethanat lehtësuese	2	4	4 për secilin	3 për secilin	5
Rrethanat rënduese	1	Nuk gjeti	Nuk gjeti	Nuk gjeti	3
Inspektorati	N/A	Ka konstatuar shkeljet	Ka konstatuar shkeljet	Ka ndalur punimet	N/A

Tabela 4.3.6. Trajtimi i rasteve në rajonin e Pejës

Në 3 nga 5 raste, Gjykata nuk ka gjetur rrethana rënduese kur ka trajtuar raste të aksidenteve në punë. Të dhënat tregojnë se në këto raste Inspektorati kishte konstatuar shkelje të dispozitave të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë por kjo nuk ishte marrë si rrethanë rënduese.

Në një rast, Gjykata vendosi ta zëvendësojë dënimin me burg në dënim me gjobë për pronarin e një biznesi që ishte mbyllur plotësisht për shkak të rrezikshmërisë së madhe të sigurisë në vendin e punës.

Prokuroria e Pejës në këto raste ka qenë relativisht e shpejtë në konkretizimin e hetimeve duke ngritur aktakuza të shpejta që nga ngjarjet kritike të ndodhura.



### 4.3.7 Trajtimi i rasteve në rajonin e Mitrovicës

Në rajonin e Mitrovicës janë analizuar dy raste të trajtuara nga Gjykata. Në rastin e parë, Gjykata ka trajtuar një recidivist të shkeljeve ligjore të cilit i është shqiptuar dënimi me burg. Procedura gjyqësore në tërësi për këtë rast që nga ngjarja kritike deri në fjalën e dytë të Gjykatës ka zgjatur gati 6 vite.

Në dy rastet e analizuar, Gjykata ka gjetur rrethana rënduese për të akuzuarit, duke vlerësuar përgjegjësinë penale e pasojat e shkaktuara të lëndimeve të rënda trupore deri te humbja e gjymtyrëve të trupit.

Gjykata Themelore Mitrovicë	Rasti 1	Rasti 2
Ngjarja kritike	22.09.14	22.05.14
Policia/ Prokuroria	Dëshmitarë - Këqyrje të vendit të ngjarjes Forenzika - Ekspertiza mjekoligjore	
Aktakuza	20.12.2016	11.06.2020
Vepra penale	Neni 367 par.5 dhe 2	Neni 358 par. 5 dhe 2
Dënimi i paraparë	Deri në 5 vite	Deri në 5 vite
Dënimi i shqiptuar	10.10.2022 7 muaj burgim efektiv (rigjykim)	18.8.2021 6 muaj burgim, zv. me gjobë 3,600 euro
Rrethanat lehtësuese	4	3
Rrethanat rënduese	3	2
Inspektorati	Ka konstatuar 7 shkelje	Ka konstatuar shkeljet

Tabela 4.3.7. Trajtimi i rasteve në rajonin e Mitrovicës

Prokuroria në të dy rastet e analizuar kishte kërkuar nga Gjykata të kishte parasysh rrethanat lehtësuese për të akuzuarit.

Në të dy rastet, pronarët e kompanive nuk kanë ndërmarrë masat e duhura për siguri dhe shëndet në punë, kurse raportet zyrtare për shkelje nga ta kanë qenë të bashkëngjitura në provat që i ka poseduar prokuroria.

## 4.4 Gjetjet e përgjithshme në trajtimin gjyqësor

Nga rastet e hulumtuara, prej 32 dënimeve të shqiptuara vetëm 2 dënime kanë qenë me burgim efektiv. Në 5 nga 27 raste në total, pronari i kompanisë dhe personi përgjegjës për siguri janë dënuar.

Dënime me burg efektiv	2
Dënime me kusht	6
Dënim me burg i zëvendësuar me gjobë	14
Dënim me gjobë	10

Tabela 4.4.1. Numri dhe lloji i dënimeve të shqiptuara nga gjykatat

- Në 7 raste gjykatat nuk kanë gjetur asnjë rrethanë rënduese
- Gjoha më e ulët e shqiptuar nga Gjykata është 460 euro, me 1 rrethanë rënduese - shkalla e dëmit
- Gjoha më e lartë ishte 3,600 euro, zëvendësim i dënimit me burg 6 muajsh
- Vetëm në një rast i akuzuari ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak deri në shpalljen e aktgjykimit
- Në 9 raste penale është përdorur raporti i Inspektoratit të Punës si provë e Prokurorisë me shkelje të konstatuara nga siguria dhe shëndeti në punë
- Në 7 raste penale, Inspektorati ka shqiptuar masa ndëshkuese - 1 mbyllje të punimeve dhe 6 gjoha ndëshkuese
- Në 11 raste penale nuk ka të dhëna mbi realizimin e inspektimit
- Në të gjitha rastet penale ka pasur ekspertizë mjekoligjore për lëndimet e punëtorëve
- Nga 31 raste në total, vetëm 7 punëtorë të aksidentuar kanë bërë kërkesë pasurore juridike për kompensim lidhur me dëmet e shkaktuara

Sipas Kodit Penal, pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoha, dënimi me kusht apo vërejtja gjyqësore ose kur kryesi lirohet nga dënimi.

Rrethanat lehtësuese që u morën parasysh kryesisht nga Gjykata ishin: pranimi i fajësisë, pendimi për kryerjen e veprës penale, rrethanat personale të të akuzuarve (mbajtës të familjeve, prindërimi e kryerja e shpenzimeve mjekësore për punëtorët e aksidentuar).

Koha sa duhet të zgjasë një shqyrtim gjyqësor është i përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale. Shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda këtyre afateve kohore, pra, prej 90 ditë nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, ndërsa duhet të përfundojë brenda 120 ditësh kur çështja trajtohet nga një trup gjykues. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdojë nëse Gjykata me vendim e arsyeton vazhdimin e atij shqyrtimi gjyqësor.

**Sipas Kodit Penal, neni 131, Efekti i zëvendësimit të dënimit me gjobë me dënim me burgim:** “Personi i dënuar, dënimi me gjobë i të cilit është zëvendësuar me dënimin me burgim, **trajtohet si person i cili mban dënimin me burgim.**”

Problemet e sistemit të drejtësisë në trajtimin e çështjeve të punës konstatohen edhe nga Avokati i Popullit. Numri i ankesave që ka pranuar ky institucion lidhur me cenimin e të drejtës në punë dhe ushtrimin të profesionit është si vijon:

Viti	Numri i ankesave
2021	138
2022	128
2023 (janar-tetor)	207

**Tabela 4.4.2: Numri i ankesave të pranuar nga Avokati i Popullit**

Sipas Avokatit të Popullit, shkeljet e konstatuara nga marrëdhënia e punës janë:

- Ndërprerja e marrëdhënies së punës në mënyrë joligjore;
- Shkelja e kohëzgjatjes së orarit të punës;
- Shkelja lidhur me kompensimin jashtë orarit të punës;
- Mohimi i të drejtës në pushim vjetor;
- Mohimi i të drejtës në pushim të lehonisë;
- Mohimi i realizimit të së drejtës në pagë.

Lidhur me mbrojtjen gjyqësore të këtyre të drejtave, Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdimisht ka tërhequr vërejtjen lidhur me zvarritjen e procedurave **gjyqësore**.<sup>18</sup>

Sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë, ky institucion së shpejti pritet të dalë me një raport lidhur me këtë çështje pas hetimeve të kryera.

Avokati i Popullit udhëheq një grup të quajtur task-forca për standardet e ndjeshme gjinore të sigurisë dhe shëndetin në punë dhe punës së denjë, ku përfshihen pushimi i lehonisë, diskriminimi, dhe kushtet e punës për gratë dhe burrat.

## 5. Ngecjet në vlerësimin e rrezikut dhe kontrollet shëndetësore

Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë ka paraparë një varg obligimesh për punëdhënësit në mënyrë që të garantohet siguria e punëtorëve në vendin e punës.

Siguria në vendin e punës, trajnimi i punëtorëve për siguri në punë, vendosja e shenjave, pajisja me kuti të ndihmës së parë, pajisja e punëtorëve, siguria ndaj zjarrit etj. janë disa nga elementet që parashihen në këtë Ligj, Ligj ky i cili sistematikisht është konstatuar se nuk po zbatohen nga bizneset.

Sipas të dhënave të Inspektoratit të Punës për vitin 2017, në Kosovë kanë qenë 16 kompani të licencuara në vend të cilat ofrojnë trajnime për siguri dhe shëndet në punë.<sup>19</sup>

BIRN ka kërkuar listën e përditësuar me këto të dhëna nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale por nuk ka marrë përgjigje. Përgjigjet mungojnë edhe për numrin dhe emrat e bizneseve që kanë përmbushur obligimin e vlerësimit të rrezikut dhe sigurisë në punë.

Vlerësimi i rrezikut në punë është proces që kryhet nga ekspertë dhe pas një procesi të kontrollit rregullohet siguria dhe ambienti i punës.

<sup>18</sup> Përgjigje e dhënë nga Zyra për Komunikim, Institucioni i Avokatit të Popullit, 05.12.2023

<sup>19</sup> <https://mpms.rks-gov.net/epdm-package/kompanite-e-licencuara-per-siguri-dhe-shendet-ne-pune/>

Dokumenti i vlerësimit të rrezikut është dokumenti ku përshkruhen karakteristikat e procesit të punës, identifikohen burimet e rrezikut, përcaktimi se kush mund të rrezikohet, nga çfarë dhe si rrezikohet, po ashtu edhe masat e nevojshme.

Të dhënat tregojnë që në vend nuk ka ndonjë databazë e cila identifikon bizneset të cilat e kanë kryer këtë vlerësim. Ndërsa numri i bizneseve që janë hasur në mungesë të këtij dokumenti gjatë inspektimeve vazhdon të jetë i lartë.

2021	2022	Janar - qershor 2023
530	N/A	610

Numri i bizneseve pa vlerësim të rrishtit në vendin e punës sipas inspektimeve të realizuara nga Inspektorati I Punës

Ngjashëm me këtë databazë mungon edhe një regjistër për numrin e punëtorëve të pajisur me certifikata shëndetësore. Në raportet statistikore të Inspektoratit të Punës afër 20% e punëtorëve të inspektuar nuk kanë kryer kontrolle shëndetësore para nënshkrimit të kontratave.

Viti	Punëtorë të inspektuar	Pa kontrata	Pa kontrolle mjekësore
2023 (janar - qershor)	23,524	1,115	4,578
2022	51,058	356	N/A
2021	38,035	1,459	2,129

Gjetjet e hulumtimit tregojnë se një numër i vogël i bizneseve gjatë viteve 2022-2023 kanë përmbushur vlerësimin e rrezikut në punë.

Lidhur me këto të dhëna, BIRN ka pranuar informata nga 5 kompani që e realizojnë këtë proces dhe ofrojnë trajnime nga lëmia e sigurisë dhe shëndetit në punë. Si rezultat, më pak se 20 mijë punonjës kanë ndjekur trajnimet e tyre. Punëtorët e tjerë vazhdojnë të punojnë pa trajnime dhe vlerësim të rrezikut në punë.

Kompania 1	Ka trajnuar afërsisht 243 kompani dhe 5,000 punëtorë
Kompania 2	Ka trajnuar 1 kompani me 1,450 punëtorë të brendshëm
Kompania 3	Ka ofruar 5,358 trajnime për siguri dhe shëndet në punë (2022)
Kompania 4	Ka ofruar 106 trajnime për siguri dhe shëndet në punë
Kompania 5	Ka trajnuar 182 kompani me 7,730 punëtorë

Tabela 5.1. Ofrimi i trajnimeve nga lëmia e sigurisë dhe shëndetit në punë

## 6. Gjobat e Administratës Tatimore të Kosovës ndaj bizneseve që shkelin ligjin

BIRN ka kërkuar nga Administrata Tatimore të dhëna lidhur me gjobat e shqiptuara ndaj bizneseve për mospagesë të kursimeve pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) të punëtorëve dhe mospërmbushje të tatimit në paga për periudhën kohore 2022 dhe janar-tetor 2023. Sipas ATK-së, legjislacioni tatimor nuk i ka të specifikuara gjobat për punëtorët jo formalë.

Sipas nenit 55 të Ligjit për Administratën Tatimore, “çdo person nga i cili kërkohet të dorëzojë një pasqyrë informatash në ATK dhe i cili nuk e bën këtë deri në datën obliguese apo i cili dorëzon një pasqyrë të pasaktë ose jokomplete do t'i nënshtrohet një sanksioni prej 125 eurosh për secilën pasqyrë të padorëzuar, të pasaktë apo të pakompletuar.”

Të dhënat e pranuar janë si më poshtë:

Viti	2020	2021	2022	2023
Numri i gjobave të shqiptuara	2,787	3,924	5,334	4,474
Vlera e gjobave	1,504,250	2,154,625	3,183,525	2,335,625

Tabela 6.1. Gjobat e ATK ndaj bizneseve

## 7. Rekomandime

- Qeveria e Kosovës duhet të harmonizojë legjislacionin e punës me standardet e Bashkimit Evropian.
- Qeveria e Kosovës duhet të vendosë standarde që kompanitë që përfitojnë nga fondet publike të respektojnë obligimet nga Ligji i punës dhe Ligji për siguri në punë.
- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë mbështetje për rritjen e strukturës kadrovike të Inspektoratit të Punës, me theks të veçantë në shtimin e numrit të inspektorëve.
- Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të saktësojnë mënyrën e zgjidhjes së kontesteve të punës me prioritet.
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të ndërtojë databaza të regjistrimit të të dhënave për punëdhënësit që kanë përmbushur procesin e vlerësimit të rrezikut në punë.
- Ministria e Shëndetësisë duhet të krijojë një databazë të regjistrimit të certifikatave shëndetësore të lëshuara për punësim.
- Shtimi i kapaciteteve të Inspektoratit duhet të kryhet duke e zbatuar standardin gjinor
- Inspektorati i Punës duhet të investojë në pajisje teknologjike për të afirmuar raportimin dhe menaxhimin e rasteve të trajtuara.
- Inspektorati i Punës duhet të dërgojë në prokurori të dhënat nga inspektimet e kryera në terren ku janë hasur vepra penale.
- Programe të veçanta të trajnimit duhet të dizajnohen për të rritur kapacitetet profesionale të Inspektoratit të Punës.
- Inspektorati i Punës duhet të ndërtojë databaza dhe metodologji të vlerësimit të rrezikut të bizneseve.
- Inspektorati i Punës duhet të hartojë procedura të llogaritjes dhe përcaktimit të dënimeve.
- Shkalla e dytë e Inspektoratit të Punës duhet të krijojë standarde të unifikuara në shqiptimin e gjobave dhe ndëshkimeve.
- Prokuroria e Shtetit rekomandohet të rrisë performancën në hetimin e aksidenteve dhe rasteve nga marrëdhënia e punës.
- Hetimet rekomandohet të kryhen me kohë dhe në afatet e përcaktuara ligjore.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të trajtojë me prioritet problemet që shkaktojnë ngecjet në trajtimin e rasteve civile.
- Gjykatësit duhet të zbatojnë politikën ndëshkimore në shqiptimin e dënimeve në çështjet e punës.



Funded by  
the European Union

'Ky raport është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të projektit "Mbrotja dhe promovimi i të drejtave të punës të grupeve të cenuara në tregun e punës". Përmbajtja e këtij artikulli është përgjegjësi e ATRC dhe BIRN Kosova dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Evropian'.

